



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:195815

Datë: 25.07.2023

Numri i dokumentit: 04518725

C.nr.1833/21

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Edije Sezairi, në kontestin e paditësit L.H. nga Prizreni, rr. “.....” të cilin me autorizim e përfaqëson i autorizuari avokat V.G. nga Prizreni, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës, M.P.M.S. Prishtinë, rr. “.....” për shkak të pasurimit të pabazë, vlera e kontestit 1.000,00 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, me datën 03.07.2023 morri këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZHET kërkesëpadia e paditësit L.H. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të **DETYROHET** “e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës, M.P.M.S. Prishtinë, që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje Kolektive nga data 01.01.2015 deri me datën 31.12.2018 për 895 ditë pune, t’ia paguaj paditësit shumën prej 1.790,00 euro si kompensim i shpenzimeve për ushqim gjatë punës ashtu siç është paraparë në marrëveshje, të gjitha këto me kamatën ligjore prej 8 % në vit, duke filluar nga data e paraqitjes të padisë dhe poashtu të obligohet e paditura që ti paguaj shpenzimet procedurale në shumën prej 606,40 euro dhe atë, për përpilimin e padisë shumën prej 78,00 euro, për 6 seanca të mbajtura me nga 101,40 euro, si dhe për taksën gjyqësore shumën prej 20,00 euro, në shumën e përgjithshme prej 606,40 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm”, **si tërësisht e pa bazuar.**

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje kontestimore gjykata e ka mbajtur në mungesë të palës së paditur i cili është ftuar në mënyrë të rregullt, fakt e cila vërtetohet nga fletëdërgesa për dorëzim personal që ndodhet në shkresat e lëndës, andaj gjykata ka vendosur konform nenit 423.4 të LPK-së.

Paditësi L.H. përmes të autorizuarës avokate E.G. nga Prizreni në këtë gjykatë ka paraqitur padinë kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës, M.P.M.S. Prishtinë, për shkak të pasurimit të pabazë. Në padinë ka theksuar se paditësi L.H. ka qenë i punësuar në M.P.M.S. që nga data 01.03.2002, pastaj nga data 01.12.2017 i njëjti është transferuar në Agjensinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, ku akoma punon në pozitën Zyrtar i trajnimit. Poashtu kanë theksuar se duke pasur parasysh se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka hyrë në fuqi që nga data 01.01.2015 deri në 31.12.2018, paditësi L.H. nga Prizreni për periudhën kohore prej 01.01.2015 deri më 01.12.2017 ka qenë i punësuar në Ministrinë e

Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe pastaj nga data 01.12.2017 është transferuar në Agjensinë e punësimit të Republikës së Kosovës, ku punon edhe sot e kësaj dite dhe deri më tani asnjëherë nuk ka marrë asnjë kompensim nga ana e Ministrisë përkatëse për shumën që e ka siguruar vetë Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive. Andaj i kanë propozuar gjykatës që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit si e bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura në përgjigje në padi e parashtruar pranë kësaj gjykate me datën 06.12.2021, e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, dhe i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Edhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësit avokat V.G. ka deklaruar se, mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke shtuar se Marrëveshja Kolektive ka qenë në fuqi nga 01.01.2015 deri me 31.12.2017, dhe duke pasur parasysh dispozitën e nenit 81 par. 1 dhe 2 të kësaj marrëveshje dhe se njëra palë nënshkruese e kësaj marrëveshje ka qenë Oda Ekonomike e Kosovës sipas njoftimit me numër 449 e datës 09.11.2017 është tërhequr nga kjo marrëveshje, dhe cili njoftim është publikuar në gazetën zyrtare me datë 13.11.2017, e që do të thotë nuk është tërhequr brenda afatit siç është paraparë në marrëveshje, andaj detyrimisht sipas par. 2 nenit 81 të kësaj marrëveshje, kjo marrëveshje do të zbatohet edhe për një vite shtesë që bie data 31.12.2018. Po ashtu ka deklaruar se nënshkruese të kësaj marrëveshje është edhe vet e paditura Qeveria e Republikës Kosovës, e cila mbikëqyrë shërbimin civil të Republikës së Kosovës në kuptim të nenit 6 të ligjit të shërbyesit civil të Republikës Kosovës, si dhe nën nenin 1 të MPKK në par.3 theksohet "Qeveria e Kosovës është garantues për implementimin të kësaj marrëveshje, të arritur me vullnetin e palëve nga par. 2 e këtij nenit. I ka kundërshtuar pretendimet e palës së paditur lidhur me arsyetimin se kërkesëpadia është e pabazuar dhe se ka arritur afatin e parashkrimit. Gjithashtu pas administrimit të provave i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit L.H. nga Prizreni të aprovoj në tërësi të bazuar, të ja paguaj paditësit shumën prej 1.790,00 euro si kompensim i shpenzimeve për ushqim gjatë punës ashtu siç është paraparë në marrëveshje, të gjitha këto me kamatën ligjore prej 8% në vit duke filluar nga data e paraqitjes së padisë dhe poashtu të obligohet e paditura që ti paguaj shpenzimet procedurale në shumën prej 606,40 euro edhe atë për përpilimin e padisë në shumë prej 78.00 euro, për 6 seanca të mbajtura me nga 101,40 euro, si dhe për taksën gjyqësore shumën prej 20.00 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin dhe vlerësimin e këtyre provave: Akt emërimi për L.H. i lëshuar nga MPMS me datë 02.03.2012, akt emërimi për L.H. e lëshuar nga MPMS të datës 16.01.2018, vërtetim i lëshuar nga Agjencia e punësimit të Republikës së Kosovës me numër 292 të datës 23.07.2021, parashtresa e dorëzuar nga Oda Ekonomike e Kosovës tek MPMS, me numër 392 të datës 15.09.2017 dhe vërtetimi i lëshuar nga Qendra për Aftësi profesionale në Prizren, me nr. referencë 98/2023 e datës 05.06.2023.

Gjykata, pas vlerësimit të theksimeve të paditësit dhe provave të administruara veçmas secilën, veç e veç dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjykata ka konstatuar se kërkesë padia e paditësit është **e pa bazuar**.

Nga leximi i akt emërimi të datës 02.03.2012 për L.H. i lëshuar nga M.P.M.S. gjykata ka vërtetuar se L.H. nga Prizreni, pranë Departamentit të Punës dhe Punësimit, Qendra e Aftësive Profesionale në Prizren është emëruar në vendin e punës si Trajner për Kuzhinë, për afat të pacaktuar dhe duke filluar të punoj nga data 01.01.2012.

Nga leximi i akt emërimi të datës 16.01.2018 për L.H. i lëshuar nga M.P.M.S. gjykata ka vërtetuar se L.H. nga Prizreni, pranë Departamentit të Punës dhe Punësimit, Qendra e Aftësive Profesionale në Prizren është emëruar në vendin e punës si Zyrtar i trajner për kuzhinë, për afat të pacaktuar dhe duke filluar të punoj nga data 01.12.2017.

Nga leximi i vërtetimit të lëshuar nga Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës me numër 292 të datës 23.07.2021, gjykata ka vërtetuar se këtu paditësi L.H. është i punësuar në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës nga data 01.12.2017. Sipas APRK i njëjti ka pozitën Zyrtar i trajnimit/kuzhinë në Qendrën e Aftësimeve Profesionale Prizren nga data 01.12.2017 dhe vazhdon të punoj.

Nga leximi i parashtrësës e dorëzuar nga Oda Ekonomike e Kosovës tek M.P.M.S. me numër 392 të datës 15.09.2017, gjykata ka vërtetuar se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social dhe nënshkrues të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, me parashtrësën në fjalë e ka njoftuar se për arsye ligjore tërhiqet nga zbatimi i MPKK-së 3 muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj.

Vërtetimi i lëshuar nga Qendra për Aftësi profesionale në Prizren, me nr. referencë 98/2023 e datës 05.06.2023, gjykata ka vërtetuar se L.H. ka qenë në marrëdhënie pune në Qendrën për Aftësim Profesional në Prizren që para 2015 dhe vazhdon të punoj e kësaj dite, më gjerësisht si në vërtetimin në fjalë.

Neni 54 i Marrëveshjes të Përgjithshme Kolektive të Kosovës, e datës 18.03.2014, ka paraparë se “Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës (prej 8 orë), për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është dy (2) euro, varësisht nga rrethanat dhe mundësitë për rastet konkrete”, mirëpo paragrafi 3 i të njëjtit nen parasheh “Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit, kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese (2 euro), të të punësuarve për ushqim”.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe analizimit dhe vlerësimit të provave të lartcekura gjykatës i rezultoi se kërkesëpadia e paditësit L.H. lidhur me kompensimin e ushqimisë dhe pretendimit të pasurimit të pabazë në dobi të të paditurës, është e pa bazuar. Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar duke u bazuar në Marrëveshjes të Përgjithshme Kolektive të Kosovës, e datës 18.03.2014, saktësisht neni 54 paragrafi 3, i cili ka paraparë qartë se “Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit, kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese (2 euro), të të punësuarve për ushqim”, e që në rastin konkret paditësi në bazë të Akt Emërimit e datës 02.03.2012 dhe Akt Emërimit e datës 16.01.2018 i njëjti ka qenë i sistemuar në vendin e punës si Trajner Kuzhiner/ Zyrtar i trajnimit kuzhinë, që do të thotë se i njëjti ushqimin e ka pas të siguruar. Ndërsa sa i përket kërkesës për kompensimin e ushqimin për periudhën 2018- 2019 gjykata të njëjtën e konsideron si të pa bazuar, pasi që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka qenë në fuqi deri me datën 01.01.2018, andaj në bazë të cekurave më lartë gjykata kërkesëpadinë e paditësit e ka refuzuar si të pabazuar.

Mbi bazën e të lartcekurave gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar dhe se e njëjta duhet të refuzohet në tërësi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është nxjerre komfor nenit 450 të LPK-së, ka paraparë që “Secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta”.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1833/21 me datë 03.07.2023

Gjyqtarja
Edije Sezairi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur, ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.